REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJË

Nr 8706 Prot.

Lushnjë, më 14 / 09 /2026

RELACION

"PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 67, DATË 20.07.2026 PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË PLANIT VENDOR PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE NË BASHKINË LUSHNJË"

Drejtuar: Këshillit Bashkiak

Të nderuar: Këshilltare/Këshilltarë

Ky relacion ka për objekt paraqitjen e nevojës për shfuqizimin e Vendimit nr. 67, datë 20.07.2026, të Këshillit Bashkiak Lushnjë, me të cilin është miratuar dokumenti i planit vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve në Bashkinë Lushnjë, për shkak të mosrespektimit të kërkesave dhe procedurave të detyrueshme të parashikuara nga Ligji Nr. 91/2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor", i ndryshuar. Dokumenti i planit vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve në Bashkinë Lushnjë është një dokument planifikimi që lidhet drejtpërdrejtë me menaxhimin e mbetjeve dhe me pasoja të mundshme në mjedis.

Për këtë arsye, procesi i vlerësimit strategjik mjedisor duhet të jetë pjesë e procedurës së hartimit dhe miratimit të tij. Ligji Nr. 91/2013 përcakton se procesit të VSM-së i nënshtrohen, ndër të tjera, planet dhe programet për menaxhimin e mbetjeve, si dhe përcakton procedurën që duhet të ndiqet përpara miratimit përfundimtar të tyre. Neni 2, pika 4, i Ligjit Nr. 91/2013 përcakton në mënyrë të shprehur se, nëse plani ose programi i propozuar për miratim nuk i është nënshtruar kërkesave të këtij ligji, autoriteti miratues nuk vijon me shqyrtimin dhe dhënien e vendimit përfundimtar, por i kërkon autoritetit propozues të fillojë menjëherë procedurat në përputhje me ligjin. Ndërkohë, neni 12, pika 1, përcakton se deklarata e ministrit përbën qëndrimin zyrtar të

ministrisë dhe është kusht i domosdoshëm për marrjen në shqyrtim për miratim të planit ose programit nga autoriteti miratues.

Pika 2 e këtij neni përcakton se kërkesa për deklaratën e ministrit bëhet pasi të jetë realizuar konsultimi dhe të jetë hartuar raporti përfundimtar i VSM-së. Gjithashtu, neni 13, pika 1, përcakton se autoriteti kompetent për miratimin përfundimtar duhet të sigurohet që, përpara marrjes së vendimit, të jenë zbatuar kërkesat e ligjit dhe propozuesi të ketë marrë deklaratën e ministrit, sipas nenit 12. Nga shqyrtimi i dokumentacionit që shoqëron Planin e Integruar të Menaxhimit të Mbetjeve të Bashkisë Lushnjë rezulton se, përpara miratimit të tij me Vendimin nr. 67, datë 20.07.2026, nuk janë përmbushur kërkesat procedurale të parashikuara nga ligji nr. 91/2013.

Bashkia Lushnje nuk ka kryer njoftimin paraprak të ministrisë përgjegjëse për mjedisin, sipas nenit 8 të ligjit, mungesa e këtij dokumenti nuk ekziston në dosjen administrative dhe miratimi i planit është kryer pa u përmbushur një procedurë ligjore e detyrueshme. Mosrespektimi i nenit 2, pika 4 e Ligjit Nr. 91/2013 është veçanërisht i rëndësishëm, pasi kjo dispozitë nuk i lë autoritetit miratues diskrecion për të vijuar me miratimin e planit kur kërkesat e VSM-së nuk janë përmbushur.

Përkundrazi, ligji përcakton se autoriteti miratues duhet të mos vijojë me vendimin përfundimtar dhe t'i kërkojë autoritetit propozues të fillojë procedurat e përcaktuara nga ligji. Për më tepër, mungesa e deklaratës së ministrit, kur ajo kërkohet nga ligji, përbën një pengesë të drejtpërdrejtë për miratimin e planit, pasi neni 12 e cilëson atë kusht të domosdoshëm për marrjen në shqyrtim për miratim, ndërsa neni 13 ia ngarkon autoritetit miratues detyrimin për t'u siguruar që kjo kërkesë është përmbushur përpara marrjes së vendimit.

Për këto arsye, Vendimi nr. 67, datë 20.07.2026, nuk duhet të mbetet në fuqi në kushtet kur procedura e detyrueshme e VSM-së nuk është përfunduar sipas kërkesave të Ligjit nr. 91/2013.

Për sa më sipër, propozohet shfuqizimi i Vendimit nr. 67, datë 20.07.2026, dhe fillimi/rifillimi i procedurave të nevojshme për hartimin dhe miratimin e Planit të Integruar të Menaxhimit të Mbetjeve, në përputhje të plotë me Ligjin nr. 91/2013.

KRYETARI I BASHKISË

Eriselda Sefa

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJË

Nr 8706/1 Prot.

Lushnjë, më 14/09/2026

PROJEKT VENDIM

NR. 78 DATË 14/09/2026

" PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 67, DATË 20.07.2026 PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË PLANIT VENDOR PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE NË BASHKINË LUSHNJË "

Këshillit Bashkiak në mbledhjen e datës___/___/2026 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë " Për shfuqëzimin e vendimit nr.67, datë 20.07.2026 **Mbi miratimin e dokumentit të planit vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve në Bashkinë Lushnjë**", në mbështetje të nenit 8 pika 2, neni 9 pika 1.1 shkronja " b ", neni 23 pika 10 të Ligjit nr. 139/2015, " Për vetëqeverisjen vendore ", i ndryshuar. Neni 8, neni 20/2, neni 24, neni 65 të ligjit nr.57/2025 " Për menaxhimin e integruar të mbetjeve". VKM-së nr.286 datë 17.04.2026 " Për miratimin e Programit Kombëtar Për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve". Neni 2 pika 1 shkronja " a", neni 7, 8, 9, 10, 11, 12,13 të ligjit nr.91/2013 " Për vlerësimin strategjik mjedisor". Neni 16, neni 113 i ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë". Ju :

PROPOZOJMË

1. Shfuqizimin e vendimit nr.67. datë 20.07.2026 "Për miratimin e dokumentit të planit vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve në Bashkinë Lushnjë".
2. Shfuqizimi i vendimit të përcaktuar në pikën 1 bëhet për shkak të mosrespektimit, përpara miratimit të planit, të kërkesave dhe procedurave të detyrueshme të parashikuara nga ligji nr. 91/2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor", të ndryshuar.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Vendor dhe Mjedisit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes

DREJTORIA JURIDIKE

Bedri Hida

KRYETARI I BASHKISË

Eriselda Sefa

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com